



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Adresa: Bulevardi "Zog I", Godina 57/2, Nr.18 Tiranë,

Tel/Fax: 04 2268141; 2268142

Nr. 553/6 Prot.

Tiranë, më 27.12.2016

**V E N D I M**

Nr.163, Datë 27/12/2016

**Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin Drejtoria e Bujqësisë Vlorë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe në zbatim të planit vjetor të punës, miratuar me vendimin nr. 1, datë 06.01. 2016, nëpërmjet vendimit nr. 138, datë 30.12.2015 "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe në institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil", Komisioneri ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe në institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil dhe konkretisht në institucionin Drejtoria e Bujqësisë Vlorë,

**VËREJ SE:**

Me vendimin nr. 138, datë 30.12.2015 "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil", Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e procesit të mbikëqyrjes së përgjithshme në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil. Bazuar në këtë vendim, ka vijuar mbikëqyrja edhe në institucionin Drejtoria e Bujqësisë Vlorë.

Objekti i mbikëqyrjes përfshin veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, e në vijim.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 553 prot., datë 07.09.2016, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili me shkresën nr. 553/1 prot., datë 07.09.2016, *“Njoftim në lidhje me mbikëqyrjen në Drejtorinë e Bujqësisë Vlorë”*, i është njoftuar Drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë Vlorë.

Drejtoritë e Bujqësisë përfshihen për herë të parë në shërbimin civil me ligjin nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar sipas parashikimeve të nenit 4, pika 1, shkronja *“a”*. Përfshirja e drejtorive të bujqësisë në listën e institucioneve të administratës shtetërore, që hyjnë në fushën e shërbimit civil, është parashikuar në mënyrë të shprehur në lidhjen nr. 1, (me numër rendor 88), që është pjesë e vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar me VKM nr. 262, datë 25.03.2015.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 553/2 prot., datë 16.11.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, *“Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin Drejtoria e Bujqësisë Vlorë, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”*, duke i lënë një afat 15 ditë kohë për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Me shkresat nr. 553/3 prot., datë 16.11.2016 dhe nr. 553/4 prot., datë 16.11.2016 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, *“Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin Drejtoria e Bujqësisë Vlorë, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”*, projektraporti i mbikëqyrjes i është dërguar për njohje, respektivisht, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, që është ministria nga e cila varet institucioni i mbikëqyrur dhe Departamentit të Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse në këtë rast.

Nërkohë subjekti i mbikëqyrur pasi është njohur me projektraportin, me shkresën nr. 1484/1 prot., datë 06.12.2016, *“Dërgohet projektraporti”*, (protokolluar pranë Komisionerit me nr. 553/5 prot., datë 15.12.2016), ka dërguar projektraportin e nënshkruar nga personat përgjegjës pa bërë vërejtje, në lidhje me gjetjet e grupit të punës të pasqyruara në të.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, referuar Seksionit III, *“Procedura hetimore”*, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, si dhe Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

## V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin Drejtoria e Bujqësisë Vlorë, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.
2. Njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike si dhe njësia e burimeve njerëzore të institucionit të mbikëqyrur, duhet të marrin masa dhe të tregojnë kujdes, që procedurat që kanë lidhje me menaxhimin e shërbimit civil dhe janë kryer në mënyrë elektronike, t’i materializojnë ato edhe në formë shkresore, duke respektuar mënyrën dhe elementët që duhet të përmbajë kopja në letër e dokumentit elektronik, të përcaktuara në ligjin nr. 9880, datë 25.02.2008, “Për nënshkrimin elektronik”, i ndryshuar; ligjin nr. 10273, datë 29.04.2010, “Për dokumentin elektronik” si dhe në udhëzimin nr. 1, datë 31.12.2012, të Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit, “Për vërtetimin e kopjes në letër të dokumentit elektronik nga institucionet publike”.

Me qëllim kontrollin e zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil nga nëpunësit përgjegjës, në përputhje me hierarkinë administrative, ashtu dhe nga institucionet e ngarkuara nga ligji për mbikëqyrjen e shërbimit civil, këto kopje duhet të trajtohen në përputhje me kërkesat e ligjit për arkivat dhe normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Në këtë këndvështrim, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore duhet të finalizojë procesin e hartimit të përshkrimeve të punës, duke u kujdesuar që të merret mendimi i Departamentit të Administratës Publike dhe më tej t’i depozitojë ato në arkivin e institucionit, si dhe pranë Departamentit të Administratës Publike.

3. Njësia e burimeve njerëzore e institucionit të informojë Sekretarin e Përgjithshëm të ministrisë së linjës dhe njësinë përgjegjëse lidhur me nivelin e diplomës së arsimit të lartë që zotëron punonjësi \*\*\*\*\*.

Njësia përgjegjëse (DAP) pas kryerjes së verifikimeve të nevojshme, të vijojë me përfundimin e procedurës së deklaramit të statusit të punësimit për këtë punonjës.

4. Për të rregulluar ligjshmërinë e procesit të ristrukturimit në institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Vlorë, njësia përgjegjëse (DAP), në zbatim të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe nenit 111, 113, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në lidhje me punonjësit \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* të cilët janë transferuar në një pozicion pune jashtë shërbimit civil, duhet të anulojë pjesërisht aktin administrativ nr. 2973/1 prot., datë 22.06.2015, “Mbi transferimin e disa nëpunësve për shkak të ristrukturimit të Drejtorisë së Bujqësisë Vlorë”, duke vepruar si më poshtë:

- Të anulohen pikat 2, 3 dhe 4 të aktit administrativ nr. 2973/1 prot., datë 22.06.2015, të Departamentit të Administratës Publike, “*Mbi transferimin e disa nëpunësve për shkak të ristrukturimit të Drejtorisë së Bujqësisë Vlorë*”, në lidhje me transferimin e punonjësve \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* në pozicionin e punës, “*Specialist*”, pranë Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural.
  - Njësia përgjegjëse të nxjerrë aktet individuale të lirimit nga shërbimi civil, për punonjësit \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* , për shkak të përfundimit të marrëdhënies së punës, në kuadër të ristrukturimit të Drejtorisë së Bujqësisë Vlorë.
  - Në zbatim të nenit 50, pika 8, shkronja “a”, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, t’u njohë punonjësve \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* , të drejtën që brenda periudhës 2-vjeçare, nga data e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, të konkurrojnë si nëpunës civil për procedurën e lëvizjes paralele apo të ngritjes në detyrë, në pozicione pune të shërbimit civil dhe të njoftohen punonjësit për këto akte.
5. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **30** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
  6. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, Drejtoria e Bujqësisë Vlorë, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
  7. Për këtë vendim të njoftohet Drejtoria e Bujqësisë Vlorë, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Departamenti i Administratës Publike, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.
  8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONERI

**Pranvera STRAKOSHA**